



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të Rregullores për Ndarjen e Bursave për Studentë të Komunës së Vitisë Nr. 01-013/246, neni 3,6,8,9 dhe neni 10, si dhe buxhetit të planifikuar dhe të paraparë për këtë destinim, Drejtoria për Arsim e Komunës së Vitisë, shpallë:

KONKURS PUBLIK

Për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Vitisë, për vitin akademik 2016/17

Drejtoria për Arsim e Komunës së Vitisë, shpall konkurs publik për ndarjen e **130** bursave, në vlerë **300.00 €** (treqind euro), për vitin akademik 2016/17. Bursat ndahen për studentë për fakultetet/lëmenjtë deficitar, për studentë të familjeve përfitues të ndihmës sociale, studentë të familjeve të dëshmorëve të luftës, invalid të luftës dhe veteran të luftës, si dhe studentë të familjeve pa prind në jetë.

Kriteret për aplikim:

- Të jetë student i Komunës së Vitisë.
- Të jetë student i rregullt në Universitetin Publik të Republikës së Kosovës.
- Të jetë student i fakultetit/lëmenjtë deficitar.
- Të jetë student i familjes me asistencë sociale, studenti/ja që nuk i ka në jetë prindërit.
- Studenti/ja që studion së bashku me një anëtar nga e njëjta familje.
- Të jetë student i familjes së dëshmorëve të luftës, invalidëve të luftës dhe veteranëve të luftës.
- Përparësi në fitimin e së drejtës në bursë kanë studentët/et që studiojnë në lëmenjtë deficitar.

Dokumentet e nevojshme për aplikim

- Për studentë fillestar nevojitet diploma e shkollës së mesme, indeksin e fakultetit fotokopje.
- Studentët të cilët kanë përfunduar ndonjë vit akademik, të sjellin çertifikatën e notave (indeksin fotokopje).
- Dëshminë e gjendjes sociale.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Viti. Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, ndërsa dokumentet e pakompletuara nuk merren në shqyrtim.

Viti, më 09.11.2016

DKA-Viti
